



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2023:275063

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05485066

C.nr.2023:275064

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me gjyqtaren Kreshnike Zymberi Beqiri, me bashkëpunëtoren profesionale Vjosa Hasani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, kundër të paditurit I.D. nga fshati .... Komuna ..., për çështjen objekt kontesti rimbursim i dëmit material dhe jo material, jashtë seance me datën 21 mars 2024, morri këtë;

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET së është tërhequr padia me numër C.nr.2023:275064, e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, kundër të paditurit I.D. nga fshati ... Komuna ..., lidhur me çështjen juridike rimbursim i dëmit material dhe jo material.
- II. OBLIGOHET paditësja që të paguaj taksën gjyqësore për parashtrimin e padisë në shumë prej 20.00€ (njëzetë euro) në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore- përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja përmes përfaqësueses së saj, ka ushtruar padi më datë 11.12.2023, kundër të paditurit lidhur me çështjen juridike rimbursim i dëmit material dhe jo material.

Me datën 29.02.2024 në gjykatë nga e autorizuar e paditëses, është dorëzuar parashtrësja me anë të së cilës, paditësja ka bërë tërheqjen e padisë pasi që me palën e paditur ka arritur marrëveshje jashtë gjyqësore dhe i padituri e ka përmbushur në tërësi obligimin e tij.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387 par.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata lidhur me shpenzimet ka vendosur konform nenit 450 të LPK-së, që paditësja të paguaj taksën gjyqësore për parashtrimin e padisë në shumë prej 20.00€.

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

C.nr. 2023:275064, me datën 21 mars 2024

**Gjyqtarja**

**Kreshnike Zymberi Beqiri**

**KËSHILLË JURDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.